

Date 02.03.2018

Civ. Them.

U PARAQIT SOT ME

Date 19.03.18

Kryesekretare  
Marsida Shullani

KERKESEPADI

PADITES:

- 1) **AZMI TOPTANI**, i biri i Ahmetit dhe i Merjemes, i datelindjes:10.05.1957, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 16, Tirane, i perfaqesuar nga **Qemal Mulla**, sipas prokures se pergjithshme date 10.10.2016, me numer rep. 3151 dhe numer kol. 912, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II , apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.
- 2) **BIHTER TOPTANI**, e bija e Ahmetit dhe e Merjemes, e datelindjes:25.12.1955, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 17, Tirane, e perfaqesuar nga **Qemal Mulla** me prokuren e pergjithshme date 22.07.2016, me numer rep. 2173 dhe numer kol. 673, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II , apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.
- 3) **ALMA STRUGA**, (Toptani), e bija e Ahmetit dhe e Merjemes, e datelindjes:29.05.1960, lindur dhe banuese ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 18, Tirane, e perfaqesuar nga **Qemal Mulla** me prokuren e pergjithshme date 22.07.2016, me numer rep. 2173 dhe numer kol. 673, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II, apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.
- 4) **MIMOZA JERO**, (Toptani), e bija e Ahmetit dhe e Merjemes, e datelindjes:21.02.1965, lindur dhe banuese ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 19, Tirane, e perfaqesuar nga **Qemal Mulla** me prokuren e pergjithshme date 22.07.2016, me numer rep. 2173 dhe numer kol. 673, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II, apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.
- 5) **REZAR MULLAJ**, i biri i Neimit dhe i Bibikes, i datelindjes:12.05.1941, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 33, Tirane, i perfaqesuar nga **Qemal Mulla** me prokuren e pergjithshme date 22.07.2016, me numer rep. 2173 dhe numer kol. 673, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II , apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.
- 6) **JASEMIN KOSHA**, (Mullaj), e bija e Neimit dhe e Bibikes, e datelindjes: 19.07.1945, lindur dhe banuese ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla I, Apartamenti 16, Tirane, e perfaqesuar nga **Qemal Mulla** me prokuren e pergjithshme date 22.07.2016, me numer rep. 2173 dhe numer kol. 673, Notere Ledina Malaj, me adrese njoftimi per gjykatën, Rruga "Georg W.Bush" Kulla II, apartamenti nr. 33, email [mullajmili@gmail.com](mailto:mullajmili@gmail.com) , tel. 0035674824146.

7) **ABAS HAMZARAJ**, i biri i Nurit dhe i Medihase, i datelindjes: 28.08.1956, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 31, Tirane, i perfaqesuar nga Av.Sokol Dedndreaj me prokuren te posacme date 28.02.2018, me numer rep. 705 rep dhe numer 182 kol, Notere Ledina Malaj.

8) **JUSUF HAMZARAJ**, i biri i Nuriut dhe Medihase, i datelindjes: 10.09.1944, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga "George Bush", Kulla II, Apartamenti 31, Tirane i perfaqesuar nga Av.Sokol Dedndreaj me prokuren te posacme date 28.02.2018, me numer rep. 705 rep dhe numer 182 kol, Notere Ledina Malaj.

**TE PADITUR:** 1.**ANA MITRO (VEVEÇKA)**, e bija e Jorgjit, e datelindjes 18.12.1937, lindur ne Tirane dhe banuese ne Durres, ne rrugen "Taulantia", pallati nr. 1000/1.

2.**FOTAQ KONOMI**, i biri i Ksenofonit, i datelindjes 05.11.1937, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, ne adresen Lagjia Uji i Ftohte, nr. 2/40 banese.

3.**VASILLAQ GOXHOMANI**, i biri i Kristaqit, i datelindjes 18.08.1932, lindur ne Berat dhe banues ne Berat, Lagjia "13 Shtatori", nr.1/86 banese.

4.**ELENI MIMA**, e bija e Konstandinit, e datelindjes 06.03.1946, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, ne adresen Rruga "Myslym Shyri", pall 6, Shk 4, Ap 31.

5.**POLIKSENI MIMA**, e bija e Konstandinit, e datelindjes 17.08.1932, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres, Lagjia nr.2, banesa 12/56.

6.**MARJETA MIMA**, e bija e Vasilit, e datelindjes 13.11.1953, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, ne adresen Rruga "Myslym Shyri", pall 6, Shk.4, Ap.31 ose ne adresen Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla nr.4.

**7. AGJENSIA E TRAJTIMIT TE PRONAVE**, adresa rruga "Muhamet Gjollesha", Tirane.

**OBJEKTI:**

1. Detyrimin e te paditurve te na njohin pronare mbi nje siperfaqe prej 275 ha (dyqind e shtatedhete e pese hektare) te ndodhur ne Hamallaj Durres, Njesia Administrative Sukth, ne zonen kadastrale 1925 dhe 3241, me kufij: Lindje: Hendeku i Vorbes qe e kufizon me pyllin e Zija Beut e Ramazan Lalen, Veri : Me vijen e mullirit te Ali Bej Qorraliut e vellezer deri ku derdhet ne det, Perendimi : Me detin Adriatik ku derdhet vija e mullinit deri ne kufi te Rrushkullit, Jug : Me pyllin e Rrushkullit te Shoqerise anonime E.I.A.A. duke filluar nga derdhja e hurdhes Pepes ne det tuj rimat drejt lindjes deri ku puqet me Kallam te Vorbes. (kufizimet sipas dokumentit hipotekor).

2.Detyrimin e te paditurve te liroje dhe te dorezoje kete prone te paluajtshme te ndodhur ne Hamallaj Durres, Njesia Administrative Sukth, qe perfshihet ne zonen kadastrale 1925 si dhe ne zonen kadastrale 3241 Durres.

3. Marrjen e mases se perkohshme te sigurimit te padise duke urdheruar

ZVRRPP Durres te pezulloje çdo veprim juridik mbi siperfaqen prej 275 ha të ndodhur në Hamallaj Durres, ZK, 1925 dhe ZK.3241 deri ne perfundim te shqyrtimit te kesaj mosmarreveshjeje gjyqesore me vendim te formes se prere.

4. Detyrimi i ATP te beje rregjistrimin e vendimit perfundimtar ne rregjistrin e vendimeve te ketij organi, ne perputhje me nenin 30/4 te ligjit 133/ 2015 per Trajtimin e prones.

**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikes se Shqiperise neni 11, 41, 42, 43.  
Konventa Europiane e Te Drejtave te Njeriut neni 6, neni 1, i Protokollit nr.1.

Kodi Civil neni 141, 149, 150, 163, 165, 192, 193, 197, 199, e vijues, 296 e vijues.

Kodi i Procedures Civile nenet 32, 41, 43, 153, 154, 202 e vijues.

Ligji nr: 133/2015 "Per trajtimin e prones dhe perfundimin e procesit te kompensimit te pronave", neni 30/4

Vendimi Unifikues nr.4, date 10.12.2013, i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.

Vendimi Unifikues . 3 dt.28.04.2014, i Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte.

**DREJTUAR:** Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

### **I nderuar Trup Gjykues!**

Trashegimlensesi Azmi Toptani, ka pasur ne pronesi te tij, para zbatimit te reformes agrare, pasuri te paluajtshme, te ndodhur ne çifligun Hamallaj Durres, prone kjo e regjistruar ne regjistrat kadastrale te kohes. Prona ne Hamallaj te Durresit, vjen trashegim trashegimtareve te Azmi Bej Toptanit qe nga periudha Osmane dhe pikerisht nga Abdurrahman Bej Toptani, Sundues i Tiranes nga viti 1822-1837 dhe me pas nga djali i tij Ahmet Bej Toptani i cili ishte gjithashtu Sundues i Tiranes nga viti 1837- 1885. Kjo prone ose sic njihej ne ate kohe Cifliku Hamallaj ka qene i ndare ne dy pjese: **Hamallaj e Siperme e Zoteruar nga Ahmet Bej Toptani dhe me vone trashegimtarete e tij Azmi Bej Toptani dhe Fuad Bej Toptani**, ndersa pjesa tjeter e Ciflikut, Hamallaj e poshtme ka qene e vellaite te Ahmetit, Jusuf Bej Toptani.

Ne vitin vitin 1926 rezulton se ka vdekur trashegimlensesi Azmi Bej Toptani, dhe ne baze te Akt Njoftunis se Gjyqi Paqtues Shihak Akt nr. 12 dt.26/VI/1933 - (AQSH, Fondi 171, dosja VII-261 faqja 542), ka lene trashgimtare ligjore te shoqen **Bihter Toptani dhe femijet Semiha, Hiqmet, Sabirije (Bibika) e Mediha dhe Ahmet Toptanin.**

Ne, paditesit jemi trashegimtare te drejtperdrejte te subjekteve te shpronuesuar Bihter, Semiha, Hiqmet, Sabirije, Mediha e Ahmet Toptani, vertetuar kjo ne baze te deshmive te trashegimise si meposhte:

- Bazuar ne deshmive e trashegimise nr.387, date, 21.07.1992, rezulton qe trashegimtare te trashegimlensesve Bihter dhe Semiha Toptani jane Sabiha (Bibika) Azmi Toptani, Mediha Azmi Toptani dhe Ahmet Azmi Toptani.
- Bazuar ne deshmive e trashegimise nr.2592, date 08.12.1993, trashegimtare te trashegimlensesit Ahmet Toptani jane Mejreme Toptani,( e shoqja) Azmi Toptani,

Bihter Toptani, Alma Struga, Mimoza Toptani.

Ne baze te Vendimit "Per leshimin e deshmise se trashegimise ligjore" nr. 582 rep dhe nr.168 Kol dt. 14.02.2017 percaktohen trashegimtaret e Merjreme Toptanit jane Z.Azmi Toptani, Bihter.Bala ( Toptani), Alma Sruga, Mimoza Jero.( femijet)

- Me Vendimin nr.3542, date 16.10.1998 i Gjykates se Rrethit Tirane, rezulton se trashegimtare te trashegimlenseses Bibika Mulla jane: Rezar Mullaj, Jasemin Kosho (Mullaj), Nermin Fejzo (Mullaj). Duhet te theksohet se ne baze te certifikates se martesese del se emri i plote i Sabihase eshte Sabiha Bibika Mullaj (Toptani).
- Me Vendimin nr.10318, date 27.11.2008 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, rezulton se trashegimtare te trashegimlenseses Mediha Azmi Hamzaraj jane Jusuf Nuri Hamzaraj e Abas Nuri Hamzaraj.

Sikurse e cituam me lart, Trashegimlensesi Azmi Toptani ka pasur ne pronesi te tij pasuri te paluajtshme , te ndodhur ne çifligun Hamallaj Durres, e regjistruar ne regjistrat kadastrale te kohes nje siperfaqe toke prej 275 ha, prone kjo e cila eshte konfiskuar nga shteti komunist shqiptar ne vitin 1945.

Kjo e drejte pronesie provohet ne baze te akteve dhe dokumenteve te meposhtme:

- referuar dokumentave historike Bashkia e Tiranës si dhe wikipedia, Prona e Hamallajt ose Çifliku Hamallaj ka qene i ndare ne dy pjese: Hamallaj e Siperme e Zoteruar nga Ahmet Bej Toptani dhe me vone trashegimtaret e tij Azmi Bej Toptani dhe Fuad Bej Toptani ndersa pjesa tjeter e Çiflikut ka qene e vellaite te Ahmet Bej Toptanit, Jusuf Bej Toptani.

Ne baze te Akt Njoftunis se Gjyqi Paqtues Shijak Akt nr. 12 i viti 1933 - (AQSH , Fondi 171, pa vit, dosja VII-261 faqja 542), rezulton se ka lene trashgimtare te shoqen, Bihter Toptani dhe femijet Semiha, Hiqmet, Sabirije (Bibika) , Mediha dhe Ahmet Toptanin. Ne permbajtjen e kesaj Akt-Njoftunie kemi keto te dhena:

- 1- **AKT-NJOFTUNIE** ....ma pare i ndjeri Azmi Toptani dhe mbas vdekjes se tij trashegimtaret e ketij Zonja Bihter (bashkeshortja e Azmi Toptanit) dhe Semiha, Hiqmet, Sabirije e Mediha dhe Ahmeti (femij te te ndjerit Azmi Toptanit) banuesa qe te gjithë ne Tirane, zotnojne e posedojne me mirebesim dhe pa as ma te voglin kundershtrim ne Katundin Hamallaj e Siperme nji cope toke me emen fusha Ali Bej e perbame prej njiqind e dyzet e tete dynym e kufizume nga L. trashegimtaret e Adem Toptanit, nga Perendimi Fuat Beu ngas V. Pjeter Cani, nga Jug Zoja Toptani. Nji cope pylle me emen Zhyme e Deti nga Veriu Ali Bej Qorrailiu, nga Jugu Zija Toptani....

Me kete dokument tregohet qarte origjina e prones dhe trashegimtaret e Azmi Toptanit duke percaktuar edhe kufinjte natyrore te kohes.

- 2- Ne baze te dokumentit kadastral, pergjigje nga Keshilli i Qarkut Durres Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes terhequr me shkresen nr 660/1, date 27.05.2009, libri 5, me permbajtje "Akt Verifikimi i transkriptuem", date: 20/09/1933, dokument i cili ndodhet ne ruajtje ne Zyren e Kadastres se Qarkut Durres rezulton se:

.. pronën qe Azmi Toptani qe ka te trashegume nga Ahmet Beu, dhe pas vdekjes Azmiut e kane trashegue femijet e Azmi Beut ne Hamalle me Siperfaqe afersisht 300 Ha me kufi:-

ndje me Zija Beut tuj rimat derdhet ne hendekun per bri vijes se Vorbes qi ndan pyllin e Zia Beut dhe Atif Beut e tuj vazhdue me pyllin e Fuad Beut deri ku takohet hendeku me vije te mullinit. - Veri Me vije te mullinit te Ali Bej Qoraliut qe derdhet ne Adriatik.

- Perendim me detin Adriatik tuj fillu prej vijes mullinit deri ne kufi te Rrushkullit me Hamallajn.

Po nga permbajtja e ketij akti rezulton se: Komisioni i verifikimit nga kqyrja e dokumentave ka konstatuar se ne baze te urdherit nr.1592 dt.10.3.1928 dhe nr. 334/1 dt.13.3.1928 eshte ngritur nje komision i cili ne raportin e dt.10.03.1930 relatuar Ministrit, ka deklaruar se Shallvari nuk ka patur prona ne Hamallaj.

Pas verifikimeve te te gjitha dokumentave dhe percaktimit te pronave te Fuat Toptani dhe Azmi Toptani eshte nxjerre dekreti nr. 741/7 dt.10.10.1933 sipas te cilit per pronen e Azmi Toptanit ngarkohen per me pagu takse trashegimtare e tij, znj Bihter dhe femijet per siperfaqen 275 ha pyje dhe kenete ne Hamallaj.

- 3- Sipas dokumentit te ZVRPP, Durres, dt.15.06.2009, Rregjistri i Transkriptimeve te vitit 1942, i Hipotekes se Durresit, fletet 388 -390 te **rradhorit nr.15 viti 1942** rezulton se:

Me 18 dhjetor 1942 eshte leshuar Note Transkriptimi ne favor te Znj.Mediha e bija e te ndjerit Azmi Toptani dhe Z.Ahmet i biri i te ndjerit Azmi Toptani kundra ZnjBihter Toptani, Znj, Semiha, Znj.Bibika "Sabire" dhe Znj Hiqmet Toptani. Ne baze te aktit publik nr. 8720 rep dt 15 shtator 1942, midis trashegimtareve te Azmi Bej Toptanit, gruas se tij Bihter Toptani dhe Femijeve Semiha, Hiqmet, Bibika \*Sabiha ) Mediha dhe Ahmet Toptani eshte bere ndarja e pasurise se trasheguar nga Azmi Toptani te percaktuar ne Akt Njoftunine e Gjyqit te Paqit Shijak, nga kjo ndarje Znj.Mediha dhe z.Ahmet Toptani kane ne pronesi te tyre : 1. Pasunine pyll e kenet ne Hamallaj te Durresit me siperfaqe Hektare dyqind e shtatedhejtepese, nga matjet ekzakte te kryme prej teknikut te Shoqerise EIAA dhe skices se inspektorit te pyjeve te vitit 1928 prona eshte me e madhe e merret trupnisht me cka ndodhet brenda kufizimeve, ne Lindje me hendek te Vorbes qe e kufizon me pyllin e Zia Beut e Ramazan Lalen, Veri me vije te mullinit te Ali Bej Qoraliut e vllazen deri ku derdhet ne det, Perendim me Detin Adriatik ku derdhet vija e mullinit deri ne kufi te Rrushkullit, Jug me pyllin e Rrushkullit te Shoqerise anonime EIAA tuj fillu nga derdhja e Hurdhes Pepes ne det tuj rimat drejt lindjes deri ku puqet me kallam te Vorbes ... Prona e pasqyruar ne skicen me germen "A" duke u percaktuar dhe detyrimet qe keta mbartin lidhur me respektimin e kontrates se qirase se lidhur me shoqerine EIAA me afat 20 vjecar etj.....

- 4- Nga dokumenti i AQSH, Fondi 182 Banka e Napolit, Viti 1938 , Dosja 27/1 fletet 289, 290, 291 dalin te dhena per praktiken shkresore e kredise qe Bihter Toptani ka marre nga Banka "Di Napoli "viti 1940 -1942 dhe konfirmon Bihter Toptani, profesioni Pronare, Kapital i levizshem 10.000 Franga ari, pasuri imobiliare te palevizeshme toka dhe shtepi me vlere 80.000 franga ari zotesia ne tregti e mire, morali i personit shume i mire, zoteron prona imobiliare toka ne Ciflikun Hamallaj, Shijak, me nje siperfaqe rreth 290 hektare, pyll kenete te dhena me qira Shoqerise EIAA ne baze te kushteve kontraktuale te specifikuara per nje periudhe 20 vjecare. Zotron Shtepite ku ka rezidencen Shoqeria Dante Aligieri dhe aktualisht Partia Fashiste Shqiptare.Vlera e pronave imobiliare eshte rreth 80 mije franga ari.

- 5- Sipas dokumentit te AQSH, Raport i nenpunesit teknik te Ministrise Ekonomis Kombetare date. 20/IV.1944.( AQSH) faqe 171 viti 1944, dosja IV-466 fleta nr. 8 shoqeruar me skice planimetrike, faqe 171, viti 1944,dosja IV-466, fleta nr. 9., me emertimin "Mbi Verifikimin e tokave per sistemimin e

grantave ne Katundin Hamalle e Rrushkull". Ne permbajtje te ketij akti  
tuhet se: Komisioni pasi beri verifikimet e duhura te akteve te pronesise  
konstattoj se: Per pronat e trashegimtareve te Azmi Toptanit, dokumentat e pronesise u  
gjeten te rregjistruara rregullisht ne Kadaster dhe Ipoteken e Durresit per Ha 275 pyje,  
kenete dhe 148 dy toke buke, masi u shkelen kufit e prones ne vend u perpilua skica  
planimetrike duke marre per baze hartin e Shoqerise e E.I.I.A per pyllin e Hamalles qe  
ndodhet perbri Detit Adriatik me keto kufi: Veri me Ali Bej Qorrailiu prej Vijes  
Gjemzes nga Vorba e deri ku derdhet ne Det, Perendim Deti Adriakti, Jugu me  
kufirin e Ciflikut Rrushkull Hamalle prej derdhjes se Hurdhes Pepes ne Det e  
pergjat e deri ku kjo vije puqet me Vorben. Lindja me Perrojin e Vorbes qe e  
kufizon shoqerine ITALBA e pyllin e Ramazan Lales. Kete prone trashegimtarete  
e Azmi Toptanit ja kane dhene me qira provizore Shoqerise E.I.I.A. Po ne kete  
akt, ne piken 2 te tij citohet se: Nga verifikimi i tapive te z. Shallvari ne zyren e  
Kadastres dhe Ipotekes se Durresit i konstatuan pasaktesi ne siperfaqe dhe  
kufinj te prones.

Ky dokument rikonfirmon pronen me kufijte e saj natyrale te saj e shprehur qartazi si ne  
Raportin e Nepunesit te Ekonomise Kombetare, ashtu dhe ne Skicen e hatografike te  
bashkelidhur ketij raporti.

6- Viti 1923 AQSH Fondi 177, Viti 1923, Dosja 161 Fletet 154 - 166

Akti Kadastral i vertetimit te Prones se Ali Bej Qorrailiut viti 1923 mare nga Arkivi  
Qendror i Shtetit F. 177, V. 1923, D.161 F. 154- 166. Ky akt kadastror verteton pronen  
e Ali Bej Qorrailiut . Bashke me Vertetimin e prones eshte e bashkangjitur dhe skica e  
saj ku ne pjesen Jugore te kesaj prone shtrihet Cifliku i Hamalles Siperme te Azmi  
Bej e Fuad Bej Toptanit dhe te dyja keto prona reciprokisht kufizohen ne perendim  
me Detin Adriatik verejtje ky vertetim per here te fundit vertetohet katerciperisht  
dhe ne vitin 1946 me Gjyqjin qe kane bere trashegimtarete e Ali Bej Qorrailiut per  
ndarjen e prones se tyre ne Gjykaten e Prefektures Tirane nr. I vendimit 663 date  
11.12.1946 vendim ky i formes se prere i publikuar gjithashtu dhe ne Fletoren  
Zyrtare viti 1946 ne kete vendim citohen te njejtet kufi si ne vertetimin e vitit 1923.

7- AQSh fondi 628 viti 1933, Dosja 65 -tre flete 26-28, Akt noterial i Noterit Publik  
S.Shundi Kontrate shitjes Nr. 1817/1181 dt. 4/korrik 1933, Iljaz Toptani shitur z,  
Ramazan Lales pjesen e vete te trashegimise se prones ne Hamallaj nga Ahmet Toptani  
dy parcela pylli me siperfaqe 90 dy + 75 prona kufizohet ne perendim me  
trashegimtarete e Azmi Toptanit ne nji ane Ali Ahmet Qorrailiu, me nje ane Fuat  
Toptani dhe me nji ane Zija Toptani provuar me nji akt-njoftunie te Gjyqjit te Paqit te  
Shijakut me Nr 11 date 26/Qershuer /1933

8- AQSH fondi 628/A Viti 1942 Dosja 8 fq105-107 Akt Noterial i Noterit Jonuz Tafa  
me nr repertori 21755 dhe koleksioni 11723 dt tre shtator viti 1942 , Kontrate qiraje  
Kullotje , ku trashegimtarete e Fuad Bej Toptanit perkatesisht citohet 1.Zoti Myzafer  
Toptani i biri i te ndjerit Fuat lindur dhe banues ne Tirane 2. Zonja Dilfiqar Toptani  
e bija e te ndjerit Fuat lindur e banuese ne Tirane ne lagjen Xhami Sherif pronare. 3.  
Zoti Banush Tila biri i te ndjerit Asllan Lindur e banues ne katundin Shumri te  
Tiranes... " Zoti Myzafer dhe Zonja Dilfiqar Toptani deklarojne se tokat e tyne qe  
ndodhen ne Katundin Hamalle e Siperme e Qarkut te Shijakut e kufizume me dy ane  
me tokat e Trashegimtareve te Zija Toptanit nji ane tokat e trashegimtareve te  
Masar Bej Qorrailiut dhe nje ane me pyllin e Ramazan Lales e permban hamendsisht  
500 ( peseqind) dylm per ta perdor per mera per kullotje delesh , ja napin me qira per  
6 ( gjashte) muje tue fillu nga data 6/XI/1942 dhe mbaron me date 6 /maj/1943.

9- Nga dokumenti i AQSH Fondi 505, Viti 1945, Dosja 187 Dokument i vitit  
1940 Kopje e Note -Transkriptimi ne favor te shoqerise Anonime

"I.A.L.B.A" dt.19/prill/1940 Kondra trashëgimtareve të Zija Toptanit për  
nëntijën e pjesëve të tyre respektive të ndodhura në cifikun Hamalle e  
poshtme e kufizuar në veri me Atif Toptanin, Fuad Toptanin me tokat e  
trashëgimtareve të Azmi Toptanit.....

Zija  
Toptanit

10- Nga dokumenti i AQSH Fondi 498, Viti 1946, Dosja 43/1 faqe 142  
Dokument i vitit 1945- 1946 i ministrise se Ekonomise Kombetare Arkivi  
Qendror i Shtetit i cili citon; "Gjendja e Hamalles Irmath Vallmath e Koder Lac në  
vjetin bujqësor 1945-1946", *permenden pronat e trashëgimlensit të paditesve si zoterues  
pronash dhe kufizimet e prones se tij.*

Dekret i Ministrisë të Ekonomisë Kombëtare i vitit 1944, marrë nga Arkiva Qendrore e  
Shtetit F.171, V.1944. D. XIII-6 F.3.

Keto akte janë pasqyruar dhe kanë një rrjedhë kronologjike sipas dokumentacionit  
të cilat vërtetojnë në mënyrë direkte dhe indirekte të drejtën e pronësive të  
trashëgimtareve të Azmi Toptanit.

E drejta e tyre e pronësive mbi keto prona është cenuar nëpërmjet akteve ligjore dhe  
nënligjore të rregjimit të kohës në baze të cilave është bërë konfiskimi dhe  
shtetëzimi i këtyre pronave.

Konkretisht: Në zbatim të Ligjit Nr.36, datë 13/I/1945 "Mbi konfiskimin e  
pasurive të shteteve italiane dhe gjermane, që ndodhen në Shqipëri dhe nën marrjen  
nën kontroll të pasurive shtetasve të tyre" të Kryesise së Këshillit Antifashist  
Nacional Çlirimtar botuar në Gazeta Zyrtare Nr.3, faqe 3 dhe 4, Viti 1945, është  
bërë konfiskimi i pronave të trashëgimtareve të Azmi Toptanit.

Në nenin 1 të këtij ligji, përcaktohet se: "Te gjitha pasuritë shtetnore dhe  
parashtetnore, dominiale ose patrimoniale të Italisë dhe gjermanisë që ndodhen në  
Shqipëri konfiskohen".

Sipas ligjit të mesiperm, të tilla pasuri quhen jo vetëm ato që i zoterojnë shtetet e  
sipërm treguem drejt për se drejti, por edhe çdo pasuri që zotrohet prej tyre me anë  
shoqërisht apo personash të nderuëm.

Mbi bazën e këtij Ligji, me datë 10 Shkurt 1945 është nxjerre dhe "Vendim  
Konfiskimi" shpallur në Gazetën Zyrtare Nr.16, faqe 8, datë 20 Qershor 1945, i cili  
citon: *Vendim Konfiskimi të pasurisë së luftshme dhe të paluftshme të Shoqnis*  
*"E.I.A.A."*.

Komisioni i parapamun nga neni 2 i Ligjes datë 13 Kallnor 1945 mbi konfiskimin e  
pasurive të Shteteve Italiane dhe Gjermane që ndodhen në Shqipëri dhe mbi marrjen  
nën kontroll të pasurive të shtetasve të tyre, mbasi shqyrtoje propozimin Nr. 566 datë 10  
Frer bamun prej Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare mbi konfiskimin e pasurisë së  
luftshme dhe të pa-luftshme të Shoqnis "E.I.A.A." me qëndër në Sukth (Shijak). *Vendosi*  
*Konfiskimin e pasurisë të luftshme dhe të pa-luftshme të Shoqnis "EIAA" që*  
*ndodhet në Shqipëri. Urdhënohet Ministria e Bujqësisë dhe e Pyjeve me vull dore mbi*  
*pasuritë e perfolur në këtë vendim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Tirane më 10 Frer*  
*1945. Ministri i Financave Ramadan Çitaku, Ministri i Drejtësisë Manol Konomi, Ministri*  
*i Bujqësisë Dr. Medar Shtylla.*

Rezultoni e provuar se shoqëria Italiane E.I.A.A, nuk ka patur titull pronësie

thi pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme te ndodhura ne Shqiperi. Kjo  
din se pikerisht, siperfaqja prej 275 ha, ne pronesi te trashegimlensesve te  
Bej Toptanit, i eshte dhene ne posedim nepermjet nje kontrate qeraje ne vitin  
e cila asnjehere nuk mund te perbeje titull pronesie per shoqerine E.I.I.A. Fakti  
shtetezimit i dale ne emer te kesaj shoqerie nuk do te thote se titulli i pronesise i  
kerkiste kesaj te fundit, por "de jure" shpronesimi i eshte bere trashegimtareve te  
Azmi Bej Toptanit, si pronare legjitim te kesaj pasurie.

Nga ky moment nuk mund te flitet me per pronare ne Rrushkull dhe  
Hamalle. Ketu çdo e drejte mbi keto prona per familjen Toptani shuhen. Çdo akt qe  
flet mbi te drejta pronesore ose ndarje pasurie apo njohje pronaresh te tjere mbi keto  
çifligje mbas kesaj date nuk mund te ekzistojë.

- Dokumentet e AQSH Fondi i 498, Viti 1946, Dosja 10, fletet 117,123, 124,  
131 vertetojne krijimin e Fermes Shtetnore te Sukthit ku jane te pasqyruara  
nepermjet Tabeles se prodhimeve Bujqesore te Fermave dhe Fidanishteve  
Shtetnore per Vitet 1944-1945, 1945-1946 te gjitha prodhimet e kesaj Ferme.  
Pra, ky fakt rikonfirmon shtetezimin e pronave te shoqerise EIAA, ku bente  
pjesë prona ne Rrushkull e ish-pronarit Miltiadh Shallvari, te cilen e  
trashegoj gruaja e Tij Lubica Shallvari si dhe prona ne Hamallaj e Z.Azmi  
Bej Toptanit e trasheguar nga femijet e tij Ahmet Toptani dhe Mediha  
Toptani Hamzaraj.

Pala paditese disponon gjithashtu te gjitha hartat, qe tregojne planvendosjen  
e prones dhe kufijte e saj. Hartat e shoqerise "EIAA", viti 1944, me shkalle:  
1:25000, AQSH fondi 171 viti 1944, 353 nje flete.

Harta e zones Rrushkull-Hamalle-Jube viti 1937

Harte e perdorur ne gjykim nga te paditurit per njohjen e prones, punuar nga  
ekspertet Hysni Bahiti dhe Aleks Zyba.

Pala paditese zoteron dhe nje sere dokumentesh te tjera plotesuese qe permbajne te  
dhena pronesie, te cilat do te paraqiten te gjitha per shqyrtim gjate debatit gjyqesor,  
te cilat vertetojne ne menyre te pakundershtueshme te drejten e tyre te pronesise.

*kuat top?*  
*Postimi me Azmi*  
*?*  
Trashegimtarët e Azmi Bej Toptanit disponojne te gjitha dokumentat qe vertetojne  
katerciperisht pretendimin e tyre legjitim per pasurine e patundeshme qe trashegojne ne  
Ciflikun e Hamallajt te Siperme nga trashegimlensesi Azmi Bej Toptani dhe kete e  
vertetojne me te gjitha dokumentat qe posedojne te nxjerra zyrtarisht dhe te  
konfirmuara nga Institucionet shqiptare te cilat kane ne ruajtje keto dokumenta dhe  
pikerisht drejtoria e Arkivit Qendror te Shtetit (AQSH), ZRPP Durres dhe Kadastra  
Durres, si dhe hartat ate vjetra te marra nga Institucione Shtetnore si AQSH, Instituti I  
tokave Fushekruje, Instituti Ushtarak Gjeografik I Firences si dhe dok te tjera.

Dokumentat vertetojne ne menyre direkte se e gjithë zona e Ishmit ka qene prone e fisit  
se madh Toptani te cilet kane patur ndermjet tyre ndarje te qarta pronesore sipas cdo  
familjeve dhe anetareve te tyre.

Mosmarveshja mes pales paditese dhe pales se paditur ka te beje me detyrimin per  
njohje pronar te prones prej 275 ha, te ndodhur ne fshatin Hamallaj, Durres, lirim dhe  
dorezim sendi.

*cu 2*

*Zyba*



pretendim vjen per arsye se : Ne baze te vendimit nr.2653,dt. 05.10.2009 te se Shkalles Se Pare Durres, lene ne fuqi me vendimin nr. 314, dt.14.96.2011 te se Larte eshte vendosur: *Njohja e se drejtes se pronesise dhe kthimi i tyre ne natyre te paleve qe jane pale e paditur ne kete gjykim mbi siperfaqe toke te ndodhur ne Fshatin Hamallaj, res, zk 1925 dhe zk 3241 me siperfaqe totale prej..... (shiko dispozitivin e vendimit)*

*Ne baze te ketij vendimi rezulton se nga e gjithe siperfaqja e njohur dhe kthyer paleve te paditura, eshte disponuar pa te drejte ne favor te tyre edhe mbi siperfaqen prej 275 ha, prone e trashjegimtareve te Azmi Toptanit per te cilat pala paditese disponon te gjitha provat qe vertetojne te drejten e tyre te pronesise.*

Te ndodhur para faktit qe tashme te gjitha keto prona te vertetuara me dokumenta pronesie, i jane njohur dhe kthyer me vendim gjykate pales se paditur, e cila nuk disponon asnje dokument pronesie per siperfaqen prej 275 ha, i drejtohem Gjykates per rivendosjen ne vend te se drejtes sone te pronesise si nje e drejte Kushtetuese dhe ligjore.

Duke qene se nuk kemi qene pale e procesit gjyqesor te zhvilluar nga pala e paditur ne vitin 2009 e vazhdim, vendimet gjyqesore nuk kane efekt mbi ne si pale paditese ne kete gjykim, ne baze te nenit 451/a te K.Pr.C:

*Vendimi qe ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera.*

*Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.*

Gjykata e Lartë ka një praktikë të konsoliduar në interpretimin e ligjit procedural, në lidhje me gjënë e gjykuar. *"që të ndodhemi para një vendimi gjyqësor që përbën gjë të gjykuar duhet që midis dy çështjeve gjyqësore të konkurrojnë tre elemente së bashku: (i) të jenë të njëjtat palë dhe ato të kenë të njëjtin identitet juridik; (ii) çështjet të kenë të njëjtin objekt dhe (iii) të njëjtin shkak. Mjafton mungesa e vetëm njërit prej këtyre elementeve që vendimi gjyqësor të mos përbëjë "gjë të gjykuar".*

Pala paditese gezon legjitimitet aktiv ne ngritjen e kesaj kerkesepadie pasi ne baze te nenit 32/a te Kodit te Procedures Civile kerkon rivendosjen ne vend te nje te drejte subjektive, siç eshte ajo e rivendosjes se te drejtes se prone ne vend, e drejte kjo e cenuar fillimisht gjate kohes se regjimit komunist dhe me pas nepermjet vendimit nr. 314, dt.14.96.2011 te Gjykates se Larte.

Pala e paditur gezon legjitimitet pasiv sepse eshte pala te ciles i eshte njohur dhe kthyer e drejta e pronesise, pikerisht mbi pronen per te cilen ne paditesat disponojme dokumente te vjetra qe tregojne ne menyre te pakundershtueshme se ajo prone ka qene e trashegimlensit Azmi Toptani dhe nuk ka asnje lidhje me trashegimlensit e pales se paditur.

Kjo kerkesepadi eshte ne kompetencen dhe juridiksionin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres per shkaqet dhe arsyet e meposhtme:

- a) Ne baze te nenit 45 te Kodit te Procedures Civile padite per te drejta reale mbi sende te paluajtshme, ngrihen ne gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa me e madhe e tyre.
- b) 55 të K.Pr.Civle, që thotë se: *"Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente ..."*

shqyrtuar edhe *kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore....*”,

Ne vendimin Unifikues nr.4, date 10.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë analizuar dhe unifikuar se:

*“ Kur nga objekti dhe shkak i ligjor i padisë mosmarrveshja objekt gjykimi rezulton të jetë e natyres civile dhe si rezultat i zgjidhjes së pasojave të ceshtjes me natyrë civile mund të urdherohet kryerja e disa veprimeve administrative si psh: urdherimi i ZVRPP për kryerjen e fshirjes apo rregjistrimin e një prone të caktuar, atëherë shqyrtimi i ketyre ceshtjeve do të jetë kompetence e gjykatës që shqyrton mosmarrveshjen civile”.*

### ARSYETIMI LIGJOR

Se pari: Siç u parashtrua edhe me lart paditesit janë trashëgimtare ligjore, të të ndjerit Azmi Toptani, subjekt ish-pronar, i shpronësuar sipas akteve ligjore të nxjerra nga shteti komunist pas datës 29.11.1944.

Pronesia është një institut qendror i së drejtës civile dhe e drejta e pronësive është një nga të drejtat themelore, të garantuara në dispozitat kushtetuese dhe në aktet nderkombetare të pranuar nga shteti shqiptar.

Në nenin 41 të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se :

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet dhe dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

Neni 42 i Kushtetutës, shprehet se:

- “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetute dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”;

Në nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikohet se: “ Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën për gezimin në mënyrë paqësore të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës nderkombetare”.

Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj ka theksuar dhe ka interpretuar termin pasuri sipas Nenit 1, Prot.1 i cili është *autonom* dhe ka një kuptim mjaft të gjërë, duke përfshirë të gjitha pasuritë dhe asetet si dhe të gjitha të drejtat që përfshijnë një interes ekonomik të tillë si: *pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, interesat materiale dhe jomateriale si për shembull, aksione, patenta, licenca, etj.*

Si një vend që kemi ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut kemi si detyrim që të respektojmë dispozitat e saj edhe jurisprudencën e Gjykatës.

Që pretendimi i një individi të përfshihet në kuptimin e pasurisë, kerkuesi duhet të jetë në gjendje të tregojë një titull në lidhje me përfitimin ekonomik që është në lojë ose një pretendim të ligjshëm se titulli i tij do të materializohet.

akteri dhe permbajtja e se drejtes se pronesise ne kuptimin juridiko-civil eshte  
uar ne nenin 149 te Kodit Civil, sipas te cilit "Pronesia eshte e drejta per te gezuar  
ponuar lirisht sendet, brenda kufijve te caktuar nga ligji". Nga kjo dispozite, si dhe  
permbajtja e neneve 296, 302, 304 te Kodit Civil rezulton se posedimi, gezimi dhe  
onimi jane tre tagrat (pushtetet) kryesore te pronarit.

Pronesia si e drejte subjektive ka karakter: **pasuror, absolut, real, te qendrueshem**  
dhe te vazhdueshem. E drejta e pronesise nuk ka mbarim ne kohe, nuk merr fund me  
kalimin e nje afati te caktuar, pronari ne menyre te vazhdueshme dhe te perhershme  
realizon te drejten e tij te pronesise mbi sendin duke gezuar dhe disponuar lirisht ate,  
brenda kufijve te caktuar nga ligji.

Trashegimlensesi Azmi Toptani ka qene pronar i ligjshem, i nje Pasunine pyll e kenet  
ne Hamallaj te Durrësit me siperfaqe Hektare dyqind e shtatedhejtepese, nga matjet ekzakte  
te kryme prej teknikut te Shoqerise EIAA dhe skices se inspektorit te pyjeve te vitit 1928 prona  
eshte me e madhe e merret trupnisht me cka ndodhet brenda kufizimeve, ne Lindje me hendek te  
Vorbes qe e kufizon me pyllin e Zia Beut e Ramazan Lalen, Veri me vije te mullinit te Ali Bej  
Qorraliut e vllazen deri ku derdhet ne det, Perendim me Detin Adriatik ku derdhet vija e  
mullinit deri ne kufi te Rrushkullit, Jug me pyllin e Rrushkullit te Shoqerise anonime EIAA tuj  
fillu nga derdhja e Hurdhes Pepes ne det tuj rimat drejt lindjes deri ku puqet me kallam te  
Vorbes... (referoju parashtrimi i fakteve) te cilat jane konfiskuar nga shtetit ne zbatim te  
akteve ligjore te vitit 1944-1945.

Ne zbatim te ligjit nr: 9235, date: 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e  
prones", pala paditese, me daten: 14.11.2008 ka paraqitur ne Zyren Rajonale te Kthimit dhe  
Kompensimit te Pronave Durres, kerkesen me nr: 331 prot per njohjen, kthimin dhe  
kompensimin e pronave te tyre te ndodhura ne Hamallaj, Bashkia Sukth, ne zonat  
kadastrale 1925 dhe 3241, me kufij: Veri- Me vijen e Mullirit te Ali Bej Qorraliut e vellezer;  
Jug- Pyllin e Rrushkullit te shoqerise anonime E.I.A.A duke filluar nga derdhja e hurdhes se  
Pepes ne det, tuj rimat drejt lindjes deri ku puqet me kallam te Vorbes; Lindje- Me hendek te  
Vorbes qe e kufizon me pyllin e Zija Beut dhe Ramazan Lalen; Perendim- me detin Adriatik  
ku derdhet vija e mullirit deri ne kufi te Rrushkullit, (kufizimet sipas dokumentit hipotekor).

Rezulton se qe nga data e depozitimit te kesaj kerkesese ndonese kane kaluar rreth 10  
vjet akoma nuk eshte marre asnje vendim nga pala e paditur ne pergjigje te kesaj kerkesese.  
Nderkohe qe, vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, lene ne fuqi nga Gjykata e  
Larte qe ka ndryshuar vendimin e AKKP duke i njohur dhe kthyer pales se paditur pronat e  
pretenduar nga pala paditese, ne kuptimin procedural eshte nje vendim i formes se prere  
dhe ai eshte i detyrueshem per zbatim nga ky organ publik, i cili ka qene pale ne ate proces,  
referuar nenit 5, pika 17 e ligjit nr.133/2015 "Per trajtimin e prones dhe perfundimin e  
procesit te kompesimit te pronave".

Te ndodhur tashme para ketij fakti, ku pjesa prej 275 ha i eshte njohur dhe kthyer  
pales se paditur, lind e nevojshme qe ne permbushje te te drejtave tona pasurore te  
pronasise, t'i drejtohem Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres, si gjykata kompetente, per  
njohjen e te drejtes se prones, kerkesese e cila eshte teresisht e bazuar ne ligj dhe ne  
dokumentacionin perkates.

Pikerisht ky lloj gjykimi, i cili lidhet me te drejta subjektive dhe synon njohjen e te  
drejtes se prones mbi sende te caktuara, mund te behet vetem nga gjykatat e zakonshme  
civile ne perputhje me dispozitat e K. Civil dhe te K. Pr. Civile. Gjykata zhvillon nje gjykim  
themeli lidhur me titullin e pronasise duke ndryshuar apo shfuqizuar ate si dhe duke  
zgjidhur ne themel kete konflikt qe ne esence eshte nje konflikt pronasie, pra i natyres civile.

Vendimin Unifikues nr.4, date 10.12.2013, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se  
analizuar dhe unifikuar se:

Kur nga objekti dhe shkak i ligjor i padise mosmarrveshja objekt gjykimi rezulton  
te natyres civile dhe si rezultat i zgjidhjes se pasojave te ceshtjes me natyre civile  
te urdherohet kryerja e disa veprimeve administrative si psh: urdherimi i ZVRPP per  
zbatimin e fshirjes apo rregjistrimin e nje prone te caktuar , atehere shqyrtimi i ketyre  
ceshtjeve do te jete kompetence e gjykates qe shqyrton mosmarrveshjen civile".

Kjo praktike unifikuese, e cila nuk eshte cenuar as ne rastin e vendimit unifikues nr.  
3 dt.28.04.2014, eshte zbatuar ne nje sere vendimesh gjyqesore, gjate viteve ne vazhdim, nga  
Gjykata e Larte duke i konsideruar keto ceshtje te natyres civile. ( shih vendimin nr.00-2017-  
2729 dt. 19.12.2017 i Kolegjit civil te Gjykates se larte)

Ne rastin objekt konflikti gjyqesor, te drejtat e pronesise se pales paditese jane cenuar  
nga Vendimi i Gjykates se Larte, Nr. i Vendimit (314), dt.14.06.2011, i cili sic thame  
konsiderohet vendim perfundimtar per ATP, referuar nenit 5, pika 17 e ligjit nr.133/2015  
"Per trajtimin e prones dhe perfundimin e procesit te kompesimit te pronave".

Sipas ketij vendimi Te Paditurve: Ana Mitro (Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq  
Goxhomani, Eleni Mima, Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, me ane te ndryshimit  
Vendimit nr.384, date 04.01.2008 te Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave  
te Qarkut Durres dhe Vendimit nr.1070, date 24.09.2008 te Agjensise se Kthimit dhe  
Kompensimit te Pronave Tirane, ndryshuar me vendimi nr.2653, date 05.10.2009 te gjykates  
se shkalles se pare Durres, eshte vendosur:

1. Pranimin e kerkeses padise se paditesave, Ana Mitro (Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani,  
Eleni Mima dhe te ndrhyrësave kryesorë, Polikseni Mima e Marjeta Mima.

2. Ndryshimin e Vendimit nr.384, datë 04.01.2008 të Zyres Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të  
Pronave të Qarkut Durrës dhe Vendimit nr.1070, datë 24.09.2008 të Agjensisë së Kthimit dhe  
Kompensimit të Pronave Tiranë, si më poshtë:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea,  
Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia  
Llampo, mbi një sipërfaqe toke 1.575.900 m<sup>2</sup> (157.59 ha), prona "A" e ndodhur në fshatin Hamallaj  
Durrës, Zona Kadastrale nr.1925, Indeksi i hartës K - 34 - 88 - (144 - B, 129 - A, 129 - B), e kufizuar:

Veri Pasuria nr.20/1, 21/9

Jug Vija ndarëse e fshatit Rrushkull

Perëndim Bregu i detit Adriatik

Lindje Pasuria nr.134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyrë rozë në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë 1.507.500 m<sup>2</sup> (150.75 ha), e ndodhur brenda pronës "A" me  
kufizimet:

Veri Pasuria nr.20/1, 21/9

Jug Vija ndarëse e fshatit Rrushkull

Perëndim Bregu i detit Adriatik

Lindje Pasuria nr.134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyrë rozë në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U kompensohet sipërfaqja e zënë 68.400 m<sup>2</sup> (6.84 ha), në bazë të nenit 11/15 të ligjit nr.9235,  
datë 29.07.2004, i ndryshuar.

3. Ndryshimin e vendimit nr.380, datë 28.12.2007 të Zyres Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të  
Pronave të Qarkut Durrës dhe Vendimit nr.1069, datë 24.09.2008 të Agjensisë së Kthimit  
Kompensimit të Pronave Tiranë, si më poshtë:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea,  
Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia

një sipërfaqe toke 1.647.000 m<sup>2</sup> (164.70 ha), prona "B", e ndodhur në fshatin Hamallaj  
Zona Kadastrale - nr.1925, Indeksi i hartës-K - 34 - 88 (144 - B, 146 - A, 129 - D, 161 - B), e

Veri Pasuritë nr.20/1, 133/2  
Jug Vija ndarëse e fshatit Rrushkull  
Perëndim Pasuria 134 (kanal)  
Lindje Pasuritë nr.133/2, 137, 49, 146, 187  
(e pasqyruar me ngjyrë portokalli në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).  
Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë 1.505.400 m<sup>2</sup> (150.54 ha) e ndodhur brënda pronës "B" me kufizimet:

Veri Pasuritë nr.20/1, 133/2  
Jug Vija ndarëse e fshatit Rrushkull  
Perëndim Pasuria 134 (kanal)  
Lindje Pasuritë nr.133/2, 137, 49, 146, 187  
(e pasqyruar me ngjyrë portokalli në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U kompensohet sipërfaqja e zënë 144.200 m<sup>2</sup> (14,42 ha) në bazë të nenit 11/15 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave", i ndryshuar.

4. Ndryshimin e Vendimit nr.379, datë 28.12.2007 të Zyrës Rajonale të A.K.K.P.-së të Qarkut Durrës dhe nr.1071, datë 24.09.2008 të A.K.K.P.-së Tiranë dhe:

a) U njihet e drejta e pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, Jorgji Veveçka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdliqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi një sipërfaqe toke 22.294.100 m<sup>2</sup> (2229.41 ha), prona "C", e ndodhur në fshatin Rrushkull, Zona Kadastrale nr.3241, Indeksi i hartës - e pa përcaktuar pasi zona është jashtë sistemit të Z.V.R.P.P. Durrës, e kufizuar:

Veri Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria nr.87/1  
Jug Lumi Erzen dhe pasuritë nr.138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.  
Perëndim Bregu i detit Adriatik  
Lindje Pasuritë nr.1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139,  
140

(e pasqyruar me ngjyrë jeshile në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).  
Nga kjo sipërfaqe:

b) U kthehet në natyrë sipërfaqja e lirë 8.263.500 m<sup>2</sup> (826,35 ha), e ndodhur brënda pronës "C", me kufizimet:

Veri Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria nr.87/1  
Jug Lumi Erzen dhe pasuritë nr.138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.  
Perëndim Bregu i detit Adriatik  
Lindje Pasuritë nr.1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139, 140  
(e pasqyruar me ngjyrë jeshile në hartën që i bashkëngjitet aktit të ekspertimit).

c) U kompensohet sipërfaqja e zënë 14.030.600 m<sup>2</sup> (140,306 ha) në bazë të nenit 11/15 të ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave", i ndryshuar.

Nga permbajtja e këtij vendimi vihet re se një pjesë e sipërfaqes së katër pronave të cilat u janë njohur, kthyer dhe kompesuar palet të paditur, krijojnë mbivendosje me pronat e pretenduara nga pala paditese në çështje të trashëgimitarëve ligjorë të Azmi Toptanit

Perfshirja e kësaj sipërfaqe prej 275 ha në favor të trashëgimtarëve të familjes Shallvari përben cenim të drejtës së pronësive të palet paditese në këtë gjykim.

Referuar permbajtjes së këtij vendimi rezultoi se Gjykata e Shkallës së Parë Durrës e ka mbështetur vendimin e saj në favor të paleve të paditura vetëm mbi notën e transkriptimit nr.126 dt. 29.05.1946 në favor të shtetit shqiptar kundër shoqërisë E.I.I.A duke dhënë dhe kufizimit të kësaj prone përkatësisht: V- Ali bej Qorraliu, Fuat Toptani, Zija Toptani, P-Deti adriatik, J-Lumi Erzen dhe L-Qanie hanemi, Fuat Toptani.

transkriptim ka ardhur si rezultat i zbatimit të ligjit nr.36 dt.14.01.1945 Per  
n e pasurive të shtetasve italiane dhe gjermane në Shqipëri si dhe vendimit të  
mit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të kesaj shoqërie.

Por kjo gjykate nuk ka bere nje hetim të plote dhe të gjithëanshem të fakteve dhe  
ovave, të cilat rezultojnë të regjistruara rregullisht në regjistrat kadastrale të Hipotekës  
e Durresit. Kjo note transkriptimi e perdorur në cilesine proves në atë gjykim përfshin  
gjithë pronat e konfiskuara të shoqërisë E I I A në favor të shtetit shqiptar, pa u përcaktuar  
origjina e e vertete e kesaj pronësie. Ky konfiskim është bere si nje teresi tokësore që kjo  
Shoqëri posedonte në kohën e zbatimit të ligjit të konfiskimit, posedim i cili rridhte nga  
disa veprimeve juridike, sic ishin Kontrata e enfiteozes dhe Kontrata e qirase për pjesën  
275 ha me trashëgimtarët e Azmi Toptanit.

Kontrata e qirase, sipas dispozitave procedurale civile nuk përben kalim të titullit të  
pronësisë dhe si rrjedhojë "de jure", ky vendim konfiskimi ka cenuar të drejtën e pronësisë  
të pronarëve ligjorë të kesaj pasurie që në bazë të aktit hipotekor i perkiste trashëgimtarëve  
të Azmi bej Toptanit.

Provat shkresore të paraqitura në gjykim vertetojnë ligjërisht origjinën e pronës prej  
275 ha, me kufinj të përcaktuar qartazi dhe të pasqyruara në dokumenta kadastrale. Ky  
pretendim bazohet edhe në aktin e ekspertimit topografik të hartuar nga  
kompania "Gjeodetika 2010" shpk me kërkesë të trashëgimtarëve të Azmi Toptanit të cilën e  
kemi paraqitur si prove në gjykim, ku përcaktohet qartë pjesa e mbivendosjes së sip. 275 ha  
me dispozitivin e vendimit të dale në favor të paleve të paditura, të përcaktuara sipas  
parcelave që përfshihen në ZK.1925 dhe ZK.3241, Hamallaj Durres.

Qëllimi i kesaj padie (provokimi i procesit gjyqësor) është që në gjykim të vertetohet e  
drejta e paditesave për pronësinë mbi sendin, objekt material i gjykimit, se ciles, sipas  
paditesave, i kundërvihet mosqenia e se drejtes së pronësisë së të paditurit mbi atë send.

Kjo e drejtë bazohet në nenin 296 të KC sipas të cilit:

- *Pronari ka të drejtë të ngreje padi për të kerkuar sendin e tij nga cdo posedues ose mbajtës.*

Gjithashtu, neni 14 i KPRC përcakton se :

- *Gjykata ka për detyrë të zhvillojë nje proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të nje hetimi të plote dhe të gjithëanshem, në përputhje me ligjin.*
- *Ajo ben nje cilesim të sakte të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarroeshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palet( neni 16) .*

Paditesit disponojnë të gjitha provat që vertetojnë titullin e tyre të pronësisë mbi  
siperfaqen e shënuar në objektin e kërkesepadise, dokumente keto të marra zyrtarisht nga  
organet shtetërore dhe që provojnë në mënyrë të pakundërshtueshme dhe në rrjedhë  
kronologjike zoterimin e pronës nga trashëgimelënesi i paditesve.

Se dyti: Duke qene se keto prona u jane njohur dhe kthyer me vendim të gjykates  
se larte paleve të paditura, në kuptimin procedural ky vendim është i  
ekzekutueshem në cdo kohe. Duke u ndodhur para rrezikut eventual të tjetërsimit  
të pasurisë dhe mohimit të se drejtes sone legjitime të pronësisë, lind e nevojshme  
marrja e masës së sigurimit duke urdheruar ZVRRPP Durres të pezullojë cdo veprim  
juridik mbi siperfaqen prej 275 ha të ndodhur në Hamallaj Durres të specifikuar sipas  
parcelave të pasqyruara në objekt deri në përfundim të shqyrtimit të kesaj mosmarreshjeje

te vendim te formes se prere.

ese gjendet e bazuar ne nenit 202 e vijues te KPRC sipas te cilit sigurimi i padise kur ka arsye te dyshohet se e ekzekutimi i vendimit per te drejtat e paditesit do te i pamundur ose i veshtire.

Neni 202 KPRC: Sigurimi i padise lejohet kur:

a. mbeshtetet ne prova me shkrese.

Sigurimi padise lejohet per te gjitha llojet e padive dhe ne cdo faze te gjykimit derisa vendimi te marre forme te prere.

Nevoja per marrjen e mases se sigurimit se padise justifikohet nga provat qe jane paraqitur ne gjykim te cilat provojne se riparimi dhe zevendesimi i demit te shkaktuar do te ishte i pamundur te kryhej ne nje faze te mevonshme.

**Se treti:** ligji 133/2015, per "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave" ne nenin 30/4 parashikon se:

4. Çdo vendim gjykate, që ka ndryshuar vendimin e ATP-së për kthimin/kompensimin apo për vlerën e kompensimit, do t'i njoftohet ATP-së dhe do të regjistrohet në regjistrin përkatës të vendimmarrjes, i cili mbahet nga ATP-ja. Ky regjistër bashkërendohet me regjistrin aktual të vendimmarrjes së ATP-së dhe të agjencive të tjera të mëparshme kompetente për kthimin dhe kompensimin e pronës.

Per sa me siper, bazuar ne keto dispozita urdheruese ligjore si dhe ne percaktimin unifikues te vendimit nr. 4 /2013 te gjykates se larte, kerkojme urdherimin e ATP per rregjistrimin e vendimit perfundimtar ne favor te pales paditese.

Per sa mesiper, mbeshtetur ne fakte dhe prova shkesore si dhe ne nenet 149, 296 e vijues te Kodit Civil, nenet 32, 154 e vijues te Kodit te Procedures Civile:

#### KERKOJME

1. Detyrimin e te paditurve te na njohin pronare mbi nje siperfaqe prej 275 ha (dyqind e shtatedhjete e pese hektare) te ndodhur ne Hamallaj Durres, Njesia Administrative Sukth, ne zonen kadastrale 1925 dhe 3241, me kufij: Lindje: Hendeku i Vorbes qe e kufizon me pyllin e Zija Beut e Ramazan Lalen, Veri : Me vijen e mullirit te Ali Bej Qorraliut e vellezer deri ku derdhet ne det, Perendimi : Me detin Adriatik ku derdhet vija e mullinit deri ne kufi te Rrushkullit, Jug : Me pyllin e Rrushkullit te Shoqerise anonime E.I.A.A. duke filluar nga derdhja e hurdhes Pepes ne det tuj rimat drejt lindjes deri ku puqet me Kallam te Vorbes. (kufizimet sipas dokumentit hipotekor).

2. Detyrimin e te paditurve te liroje dhe te dorezoje pronen e paluajtshme ne Hamallaj Durres, Njesia Administrative Sukth, qe perfshihet ne zonen kadastrale 1925 si dhe ne zonen kadastrale 3241 Durres:

3. Marrjen e mases se perkohshme te sigurimit te padise duke urdheruar ZVRRPP Durres te pezulloje cdo veprim juridik mbi siperfaqen prej 275 ha te ndodhur ne Hamallaj Durres te specifikuara sipas parcelave te pasqyruara ne objekt deri ne perfundim te shqyrtimit te kesaj mosmarreshjeje gjyqesore me vendim te formes se prere.

4. Detyrimi i ATP te beje rregjistrimin e vendimit perfundimtar ne regjistrin e vendimeve te ketij organi, ne perputhje me nenin 30/4 te ligjit 133/ 2015 per Trajtimin e prones.

**PADITESIT**

AZMI TOPTANI BIHTER TOPTANI ALMA STRUGA (TOPTANI)

MIMOZA JERO (TOPTANI) REZAR MULLAJ

JASEMIN KOSHO

**Perfaqesuar me prokure te pergjithshme nga:**

Qemal Mulla

*Qemal Mulla*

ABAS HAMZARAJ

*Abas Hamzaraq*

*[Signature]*

JUSUF HAMZARAJ

**Perfaqesuar me prokure te posacme nga**

Ar Sokol Dedndreaj

*Sokol Dedndreaj*

*[Signature]*